



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
SEKSIONI TREGTAR

Nr. Akti 10451

Datë rregjistrimi 14 qershor 2016

Nr. Vendimi 10555



V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë nga :

Rezarta MATAJ ——— ***Gjyqtare***

me sekretare gjyqësore Ina Serjanaj, në Tiranë, sot më **27 dhjetor 2016, ora 11:00**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile që i përket :

Kërkesë:

Shoqëria "Spark Future" shpk NUIS L61626003H me seli në Rrugën "Geroge Bush", nr. 20, dy kullat përballë parlamentit, me ortak Elida Heba, Eduart Molla, Gerian Kuka dhe Gezim Gjakova.

Objekti:

Mbylljen e procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar, Ç'rregjistrimin e saj nga regjistri tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare Regjistrim.

Baza ligjore:

Neni 204 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, neni 51 i ligjit nr. 9723 /2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", neni 334 pika e I Kodit të Procedurës Civile.

Në bisedimet përfundimtare, përfaqësuesi i kërkuarit pretendoi: "*Pranimin e kërkesës sipas objektit*".

Gjykata pasi zhvilloi hetimin gjyqësor, konsultoi çështjen në tërësi në ligj material, procedural, prova dhe formoi bindjen e saj të brëndshme

VËREN se

1. Shoqëria "Spark Future" shpk (më tej Shoqëria) i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (më tej GjRRGJ Tiranë) me objekt likuidimin e thjeshtëzuar të saj sipas ligji nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

2. Kjo gjykatë si pjesë e seksionit tregtar të GjRRGJ Tiranë, ka kompetencë lëndore dhe tokësore si gjykata në rrethin gjyqësor të të cilit

ndodhet selia e Shoqërisë por edhe faktit se në statut të shoqërisë është parashikuar si gjykata kompetente që do të zgjidh mosmarrëveshjet ose kërkesat që lidhen me shoqërinë.

II. Mbi rrethanat dhe faktet e çështjes.

3. Sipas ekstratit të QKR shoqëria është krijuar me datë 26 prill 2016, mes ortakëve Elida Heba, Eduart Molla, Gerian Kuka dhe Gezim Gjakova.

4. Sipas statutit të shoqërisë dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit objekti I veprimtarisë së saj është projektim, realizim, instalim I sistemeve elektrike etj.

5. Sipas kërkesës së të tre ortakëve të shoqërisë kërkojnë të prishet shoqërie nëpërmjet likuidimit të thjeshtëzuar meqënëse nuk ka asnjë detyrim karshi të tretëve dhe shoqëria nuk ka realizuar ndonjë fitim dhe as humbje sipas bilanceve të saj. Këtë dakortësi ortakët jo vetëm që e shprehën para gjykatës por e kanë shprehur edhe para noterit public apo përpara punonjësit të ambasadeve të vëndeve ku ato ndodhen sot të datave: 27 dhjetor 2016, 09 dhjetor 2016, 10 nëntor 2016.

6. Rezulton nga provat e marrë në gjykim se që nga momenti i themelimit kjo Shoqëri nuk ka asnjë detyrim mbi fitimin e tatimit mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin tatim I mbajtur në burim, tatim mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet të sigurimeve shoqërore shëndetësore bazuar tek vërtetimet e datës 26 maj 2016 të DPT Tiranë, vërtetimi I datës 26 shtator 2016 e DPSHT RRugor Tiranë dhe Degës së Doganës Tiranë, Vërtetimi I QKB se është pasqyruar hapja e procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar, vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore të datës 05 tetor 2016 nga Bashkia Tiranë.

7. Shoqëria pretendon se duhet deklaruar e mbyllur procedura e likuidimit të thjeshtëzuar pasi plotëson të gjitha kriteret e nenit 204 të ligjit nr. 9901/2008 në kushtet kur nuk ka asnjë detyrim karshi të tretëve dhe nuk asnjë dividend për të shpërndarë për shkak të kohës së shkurtër kur ajo është krijuar.

III. Legjislacioni i zbatueshëm.

8. Kodi Civil nenet 34-37.

9. Ligji nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Neni 204

1. Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkëlja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

4. Paditë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data e cregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 205

“Dispozitat e parashikuara në nenin 202 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e përfundimit të likuidimit të thjeshtëzuar”.

IV. Analiza ligjore në prova dhe fakte e çështjes

10. Sipas neni 34 të Kodit Civil personi juridik mbaron në mënyrat e parashikuar në ligj, statut apo aktin e krijimit. Rezulton se në statutin e shoqërisë Spark Future shpk është parashikuar si formë e mbarimit të shoqërisë ajo e likuidimit .

11. Në nenin 190 të ligjit nr. 9901/2008 parashikohet se prishja e shoqërisë kur ka aftësi pagueuse bëhet me anë të likuidimit të zakonshëm ose likuidimit të thjeshtëzuar.

12. Likujdimi i zakonshëm sipas nenit 204 të ligjit synon përsheptimin e procedurave të mbarimit të shoqërisë përsa kohë shoqëria nuk ka asnjë detyrim karshi të tretëve dhe kërkohet vetëm që ajo të hiqet nga regjistri i QKR ku ajo figuron e regjistruar.

13. Dy janë kushtet që duhet të plotësohen për likujdim të thjeshtëzuar para gjykatës: 1) ortakët të vendosin bashkarisht për këtë mënyrë mbarimi të shoqërisë, 2) të deklarojnë se nuk kanë detyrime karshi të tretë 2) si dhe nuk kanë asnjë detyrim të pashlyer ndaj punëmarësve.

14. Në rastin konkret, sipas procesverbalit të mbledhjes së ortakit të vetëm është pranuar se shoqëria ka pranuar që të likujdohet në mënyrë të thjeshtëzuar, kanë deklaruar para noterit publik se nuk kanë asnjë detyrim ndaj askujt dhe as punëmarrësve dhe në prova rezultoi se nuk kishin asnjë detyrim tatimor, lokal, doganor, në zyrën e punësimit, të bashkisë apo në çdo institucion tjetër të pashlyer. Po ashtu ky vendim për likujdim të thjeshtëzuar është regjistruar në QKR-në dhe më pas të pasqyrohet dhe vendimi për ç’regjistrim të shoqërisë.

15. Sa më sipër, gjykata e gjen me të drejtë kërkesën e Shoqërisë për tu likujduar prandaj një kopje e këtij vendimi sipas nenit 202 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i dërgohet QKR-së që të ç’regjistroj shoqërinë nga regjistrat përkatës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në 102-106, 306-310, 126 të K.Pr.Civile dhe nenit 204 të ligjit me nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe neniet 51 të ligjit nr. 9273/2007 “Për qëndrën kombëtare të regjistrimit”

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Shoqëria “Spark Future” sh.pk., si të mbështetur në ligj dhe në prova.
2. Mbylljen e procedurës së likujdimit të thjeshtëzuar të shoqërisë “Spark Future” sh.p.k., me NUIS L61626003H me seli në Rrugën “Geroge Bush”, nr. 20, dy kullat përballë parlamentit, me ortak Elida Heba, Eduart Molla, Gerian Kuka dhe Gezim Gjakova.
3. Detyrimin e Qendrës Kombëtare Regjistrat Tiranë të ç’regjistrojë nga regjisri përkatës pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, shoqërine “Spark Future” shpk si shoqëri e likujduar.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më 27 dhjetor 2016!

Sekretare gjyqësore

Gjyqtare

Ina Serjanaj

Rezarta MATAJ

SHPENZIMET GJYQËSORE

(Sipas neneve 102 e 106 të K. Pr. Civile)

Taksë rregjistrimi	200 Lekë
Taksë noteriale	600 Lekë
Për njoftime	100 Lekë

TOTALI i SHPENZIMEVE: 900 Lekë

(Nëntë qind Lekë)
Sekretarja Gjyqësore

Ina Serjanaj

Vendimi mori formë të prera pasi
nuk u ankimua me dt 11.01.2017
Tiranë me dt 16.01.2017

K / SEKRETARE

Mimoza CENAJ (LULAJ)



KANCELAR
DONALD XHELILI